

1. Profili Bashkisë Tropojë

Administrata	
Sipërfaqja	1043 km ²
Popullsia	28,245 (Bashkia)
• Dendësia	37 banorë/km ²
Shteti	 Shqipëria
Qarku	Qarku i Kukësit
Rrethi	Rrethi i Tropojës
Faqja zyrtare	• tropoje.gov.al

Tropoja kufizohet në veri me Republikën e Kosovës dhe të Malit të Zi, në perëndim me Bashkinë Shkodër, në jug me Bashkitë Vau i Dejës dhe Fushë-Arrëz dhe në jug-lindje me Bashkinë Has. Qendra e kësaj Bashkie është qyteti i Bajram Currit. Kjo Bashki përbëhet nga 8 njësi administrative. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Tropojës dhe qarkut të Kukësit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Bajram Curri dhe Fierza) dhe 68 fshatra.

Figura 1: Harta e Bashkisë Tropojë



Tabela 1: Njësitë Administrative të Bashkisë Tropojë

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative	Fshatrat në përbërje
Tropojë	Tropojë	Bajram Curri	Bajram Curri
		Fierzë	Tpla, Dushaj i Poshtëm, Degë, Breg-Lum
		Lekbibaj	Brisë, Salce, Palç, Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshe, Qerreç Mulaj, Curraj i Sipërm"
		Margegaj	Margegaj, Fushë Lumi, Koçanaj, Shoshan, Lagja Paqës, Bradoshnicë, Dragobi, Çerem, Valbonë, Rragam
		Llugaj	Bukovë, Jaho Salihi, Llugaj, Luzhë, Rrez-Mali, Rragam"
		Bujan	Bujan, Rosujë, Dojan, Markaj, Gri, Lekurtaj, Selimaj, Bllatë, Gri e Re
		Bytyç	Pac, Zherkë, Vlad, Çorraj-Veliç, Berishë, Visoçë, Mash, Zogaj, Prush, Kepenek, Kam, Leniq,"
		Tropojë	Astë, Kojel, Viçidol, Kasaj, Gegaj, Buçaj, Papaj, Sopot, Babinë, Begaj, Shumice-Ahmetaj, Myhejan, Kovaç, Kërrnajë, Shkëlzen

Burimi: Bashkia Tropojë

1.1 Profili demografik

Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 20,212 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 28,245 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 1057.3 km².² Numrin më të madh të fshatrave e kanë njësitë administrative të Tropojës, Bytyçit dhe Lekbibaj, ndërsa numrin më të madh të familjeve e ka qyteti i Bajram Currit me 2,588 familje nga 9,074 familje gjithsej.

Tabela 2: Të dhëna demografike të Bashkisë Tropojë

Njësitë administrative	Numri i fshatrave	Numri i Familjeve	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil 2018
Bajram Curri	-	2,588	5,340	8,230
Fierzë	4	766	1,302	2,465
Lekbibaj	11	662	1,207	1,912
Margegaj	10	986	2,346	3,047
Llugaj	6	703	1,787	2,143

² <http://pushtetivendor.reporter.al/profili-i-Bashkise-tropoje/>

Bujan	7	941	2,550	2,881
Bytyç	13	682	1,563	2,103
Tropojë	18	1,746	4,117	5,464
Totali	69	9,074	20,212	28,245

Burimi: Bashkia Tropojë

1.2 Profili social

Asistenca Sociale

Janë 2,362 familje që përfitojnë nga Ndihma Ekonomike në Bashkinë e Tropojës ose përkthyer në frymë, 9,896 të tilla. Pagesa totale e fondit të ndihmës ekonomike në Bashkinë e Tropojës është 10,149,909 lekë ose mesatarisht 4,297 lekë për familje. Ndërkohë, sa i përket pagesës së paaftësisë, në Bashkinë e Tropojës janë të regjistruar gjithsej 754 të paaftë dhe 194 kujdestarë me një fond total të pagesës së paaftësisë që arrin 11,678,022 lekë. Qyteti i Bajram Currit dhe njësia administrative Tropojë mbajnë numrin më të lartë të kësaj kategorie, specifikisht 214 persona me aftësi të kufizuar në Bajram Curri dhe 149 në Tropojë.

Tabela 3: Të dhëna mbi përfituesit e pagesave sociale në Tropojë

Njësia administrative	Përfituesit e ndihmës ekonomike (NE)		Fondi gjithsej i NE	Numri i popullsisë përfituese (frymë) të pagesës së paaftësisë		Fondi gjithsej i pagesës së paaftësisë
	Numri për frymë	Numri i familjeve		Numri i personave me aftësi të kufizuar	Numri i kujdestarëve	
Bajram Curri	1,626	410	1,783,258	214	44	3,346,453
Fierzë	836	185	789,408	74	16	1,088,755
Lekbibaj	966	262	1,055,227	47	11	668,210
Margegaj	1,227	293	1,254,028	88	25	1,393,660
Llugaj	882	207	823,541	55	22	879,909
Bujan	916	228	925,373	81	24	1,220,580
Bytyç	1,207	268	1,313,075	46	14	859,930
Tropojë	2,236	509	2,205,999	149	38	2,220,525
Totali	9,896	2362	1,0149,909	754	194	1,1678,022

Burimi: Bashkia Tropojë

Arsimi

Me përjashtim të qytetit të Bajram Currit, në të gjithë njësitë administrative të Bashkisë Tropojë mungojnë çerdhet ndërsa kopshtet e fëmijëve janë të perfshira në shkollat kryesore të njësive administrative. Janë gjithsej 27 kopshte publike me 541 fëmijë dhe 47 edukatorë. Vetëm në Bajram Curri ekzistojnë 3 kopshte me 205 fëmijë të regjistruar

të cilët kanë përkujdesjen e 20 edukatorëve, duke patur kështu një mesatare prej 10 fëmijësh për 1 edukator në të tre kopshtet.

Numri total i shkollave 9-vjeçare në Bashkinë e Tropojës është 49 me 2,476 nxënës të regjistruar. Megjithëse njësia administrative Bajram Curri mban një numër të ulët shkollash në krahasim me njësitë e tjera administrative (vetëm 3 të tilla) aty është edhe numri më i lartë i nxënësve të regjistruar, 1,036 nxënës, të cilët arsimohen nën drejtimin e 70 mësuesve, me një mesatare prej 15 nxënësish/mësues. Numrin më të lartë të shkollave 9-vjeçare e mban njësia administrative Tropojë me 11 të tilla, e ndjekur nga Lekbibajt. Vihet re se kjo njësi administrative (Lekbibaj) megjithëse ka 10 shkolla 9-vjeçare, rezulton të ketë vetëm 94 nxënës të regjistruar. Në total, mesatarja nxënës / mësues në shkollat 9-vjeçare në Bashkinë e Tropojës është 9.

Ndërkohë përse i përket shkollave të mesme, përveç njësive administrative Margegaj dhe Bujan, të gjitha njësitë e tjera administrative, kanë nga 1 shkollë të mesme, përveç njësisë administrative Bytyç që ka dy të tilla. Numri total i shkollave të mesme është 7 me 1,972 nxënës të regjistruar dhe 136 mësues/e të punësuar me një mesatare në shkollë Bashkie 1 mësues/e për 14 nxënës.

Tabela 4: Institucionet arsimore dhe kapacitetet e tyre në Bashkinë Tropojë

Njësitë administrative	Shkollat nëntëvjeçare			Shkollat e mesme		
	Numri i shkollave nëntëvjeçare	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve	Numri i shkollave të mesme	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve
Bajram Curri	3	1,036	70	1	630	36
Fierzë	4	115	14	1	284	23
Lekbibaj	10	94	16	1	150	14
Margegaj	5	286	45	-		
Llugaj	2	109	14	1	210	18
Bujan	6	264	28	-	-	-
Bytyç	8	116	42	2	350	29
Tropojë	11	456	54	1	348	16
Totali	49	2,476	283	7	1,972	136

Burimi: DAR Tropojë

Shërbimi shëndetësor

Spektori shëndetësor i territorit të Tropojës disponon 33 ambulanca dhe 8 qendra shëndetësore (pra një në çdo njësi administrative), si dhe një spital në qytetin e Bajram Currit, me një kapacitet prej rreth 100 shtretërish, me një efektiv mjekësor prej 13 mjekësh dhe 133 infermiere.

	Qendrat Shëndetësore	mjeke	infermiere
1	QSh Bajram Curri	3	18
2	Tropojë	3	28
3	Bytyç	1	14
4	Lekbibaj	1	14
5	Fierze (BC)	1	15
6	Margegaj	1	12
7	Bujan	2	17
8	Llugaj	1	14
	Totali	13	132

1.3 Profili ekonomik

Në bashkinë e Tropojës operojnë gjithsej 417 biznese. Përqendrimi më i madh i tyre është në Bajram Curri me 322 të tilla dhe më i vogli në njësinë Lekbibaj, ku numërohet vetëm 1 i tillë. Tropoja është një zonë kryesisht bujqësore dhe blegtorale, ndërkohë që sipërfaqja e tokës bujqësore në të gjithë Bashkinë Tropojë është 3669 ha.

Tabela 6: Të dhëna mbi kuadrin ekonomik në Bashkinë Tropojë

Njësitë administrative	Numri i Bizneseve		
	Biznes i vogël	Biznes i madh	Gjithsej
Bajram Curri	-	-	322
Fierzë	-	-	14
Lekbibaj	-	-	1
Margegaj	-	-	23
Llugaj	-	-	10
Bujan	-	-	5
Bytyç	-	-	25
Tropojë	-	-	17
Totali	-	-	417

Burimi: Bashkia Tropojë

1.4 Profili administrativ

Numri total i punonjësve në 8-të njësitë administrative është 270 punonjës, prej të cilëve 45.9% janë gra, ndërkohë që bie në sy që nuk ka asnjë grua në rol drejtues. Bie në sy pozitivisht që në njësinë administrative Bajram Curri numri i grave të punësuar është 111 nga 212 që është numri total. Ndërkohë në të gjitha njësitë e tjera administrative, numri i grave të punësuar është më i ulët sesa numri i burrave.

Tabela 7: Të dhëna administrative mbi Bashkinë e Tropojë

Njësitë administrative	Numri i punonjësve		Totali
	Meshkuj	Femra	
Bajram Curri	101	111	212
Fierzë	6	3	9
Lekbibaj	7	1	8
Margegaj	6	3	9
Llugaj	4	1	5
Bujan	5	1	6
Bytyç	8	1	9
Tropojë	9	3	12
Totali	146	124	270

Burimi: Bashkia Tropojë

Më tej vetëm 19% e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak janë gra nga 21 këshilltarë në total. Përsa i përket përfaqësimit politik në Këshillin Bashkiak koalicioni i majtë mban shumicën e Këshillit Bashkiak me 11 këshilltarë përkundrejt 10 të koalicionit të djathtë.

Tabela 8: Përbërja e këshillit Bashkiak

Numri i anëtarëve të Këshillit Bashkiak			Numri i anëtarëve të Këshillit Bashkiak	
Meshkuj	Femra	Gjithsej	Koalicioni i majtë	Koalicioni i djathtë
17	4	21	11	10

Burimi: Bashkia Tropojë

1.5 Profili Financiar

Buxheti i Bashkise Tropoje perbehet nga transferta qe jep Qeveria si dhe te ardhurat qe sigurohen nga taksat dhe tarifat qe mbledh vete bashkia nga bizneset. Qeveria i ka dhene bashkise Tropoje per vitin 2019 nje total prej 290 milion leke te reja ndersa vete bashkia planifikon te mbledhe 132.7 milion leke te reja. Në total jane 423.4 milion leke te reja qe ndahen sipas sektoreve në tabelen e mëposhtme:

Tabela 9. Te dhenat e buxhetit Bashkise

000/ në lekë

Bashkia	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Tropoje	201,742	214,584	235,275

Nr	Burimet	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Te ardhura te planifikuara	132,788	111,899	116,623
2	Transferte e pakushtezuar	201,742	214,584	235,275
3	Transferte specifike	88,917	88,917	88,917
a	Arsimi baze	47,410	47,410	47,410
b	Asimi I mesem	3,490	3,490	3,490
c	Mbrojtja nga zjarri	14,705	14,705	14,705
d	Administrimi I pyjeve	11,957	11,957	11,957
e	Rruget	8,646	8,646	8,646
f	Ujitja dhe kullimi	2,709	2,709	2,709
	SHUMA Gran +ts	290,659	303,501	324,192
	Shuma e burimeve	423,447	415,400	440,815

Burimi PBA 2019 -2021

Tabela 10. Tarifa e Sherbimeve publike (pastrimit dhe largimit të mbetjeve, dhe kanalizimeve)

Nr	Kategoria I“Familje”	Njësia	Nivelet e Tarifës për Familjet
A	Familjet pa probleme		Tarife Sherbimesh
1	Qyteti Bajram Curri	Lekë/vit/familje	2200
2	Nj.Ad te Tjera	Lekë/vit/familje	1050

Tabela 11. Taksa e Tokes Bujqesore

Nr	Kategoria e Tokes	Njësia	Sipas ligjit	Miratuar nga K.Bashkiak
A				
1	Kadegoria V	Lekë/ha/vit	900	630

2	Kategoria VI	Lekë/ha/vit	800	560
3	Kategoria VII - X	Lekë/ha/vit	700	490

Tabela 12. Taksa e Truallit

Nr	Taksa mbi truallin	Njësia	Sipas ligjit	Miratuar nga K.Bashkiak
A				
1	Per qellime banimi nga idividet	Lekë/m ² /vit	0.14	0.14
2	Bisneset	Lekë/m ² /vit	12	12

Burimi : PBA 2019 -2021

1.6 Bujqësia

Bujqësia është një nga sektorët e rëndësishëm ekonomik të rajonit të Tropojës. Tropoja ka rreth 7387 ha tokë bujqësor dhe nëse llogaritet kjo sipërfaqe toke për familje në ha, kemi: 0,634 ha për çdo familje. Në shkallë rrethi, janë rreth 4800 ferma që ushtrojnë aktivitet bujqësor dhe blegtoral. Madhësia e fermës shkon nga 1-2.2 ha tokë bujqësore të punueshme. Tokat bujqësore përfshijnë të kafenjtat (77%), të murrme (22%) dhe livadhore malore (0.6%). Mbillen 780 hektarë drithëra (80 ha grurë dhe 700 ha misër), 45 ha patate dhe 167 ha perime).Sipërfaqja tjetër është me foragjere 3870 ha (nga të cilat 822 ha jonxhë).Janë 49 mije peme Frutore (mollë, kumbull ,arrë) që prodhojnë rreth 7 mijë ton fruta.

Tropoja ka masivin më të madh të gështenjave në Shqipëri por edhe në Ballkan. Ky masiv shtrihet në 2000 hektarë dhe numëron më shumë se 190,000 rrënjë. Çdo vit prodhohen 2- 3 mije ton gështenja të cilat sigurojnë rreth 3 deri 4 milion euro të ardhura për fermerët

Sipërfaqen më të madhe të sipërfaqes së tokës së punueshme e zënë bimët e arave (rreth 50%).

Tabela 13. Ndarja e tokes bujqësore sipas Njesive Administrative

Nr	Njësitë Administrative	Totali ha	Sipërfaqe e ndare ha	Sipërfaqe e pa ndare ha	% e ndarjes	Zona kadast e regj
1	Margegaj	690.4	460	230.4	66.6	9
2	Bujan	1091.6	729.6	362	66.8	6
3	Fierze	722.5	357.5	365	49.5	3
4	Llugaj	1231	668	563	54.2	4
5	Tropoje	1898	1180	718	62.1	11

6	Bytyç	979	667	312	68.1	12
7	Lekbibaj	636	356	280	55.9	2
8	B Curri	138.5	124	14.5	89.5	1
	RRETHI	7387	4542.1	2844.9	61.4	48

Burimi: Zyra e Kadastrës pranë Bashkisë Tropoje 2019.

Në gjithë territorin e Bashkisë Tropojë është rreth 45% e tokës pa kaluar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë Paluajtshme


Për vitin 2018 është mundësuar ujitja e 29% e sipërfaqes së mbjellë ose 42 % e sipërfaqes potenciale. Sipërfaqja potenciale që duhet të ujitet është jo me pak se 70% e totalit të fondit tokës.

Tabela 14, Kanalet ujitëse

NR	Menaxhuesi i Sistemit, OPU, NJQV	Emri i Burimit Ujor; Lum, Rezervuar, St.Pompash	Sipërfaq e. ha	Kanalet ujitëse & Gatishmëria				
				Kanal i pare				
				Emri	Km		m ³ Ujë / sek	
					Gjatësi	Past rim	Kapacitet	Gatishmëri
SHUMA O.P.U								
1	Tropojë	Rez. Kasaj	1898	Rez.Kasaj	11	11	0.025	0.025
2	Bytyç	Rez,Zherk 1,2,	979		11	11	0.43	0.43
3	Fierze	K.Rez. Dege	722	Dege	7	4	0.4	0.4
4	Bujan	Lumi Valbonë	1091	Krasniqe	4	3	0.35	0.35
5	Llugaj	Lumi Valbonë	1231	Krasniqe	8	5	0.4	0.4
6	Margegaj	Lumi Valbonë	690	Krasniqe	5.5	4.5	0.8	0.8
7	Lekbibaj	Kanali Curraj	636	Mesiri	8	8	0.6	0.6
8	B.Curri	Lumi Valbonë	138	Krasniqe	2	2	0.04	0.04
Shuma NJQV			7385		56.5	48.5	3.045	3.045

Burimi: Bordi Rajonal i Kullimit Kukes

Tabela 15. Numri i Blegtorise



Burimi: Drejtoria e Bujqesise dhe Ushqimit Tropoje

1.7 Infrastruktura rrugore.

Në zonën e Tropojës janë gjithsej 538 km rrugë nga të cilat 164 km janë rrugë të asfaltuara..Inventari i rrugëve sipas Njësive Administrative jepet si më poshtë.

Nr	Njësia Administrative	Gjatësia (km)
1	Fierze	40.4
2	Tropoje Fshat	77.2
3	Bujan	72.8
4	Bytyç	57
5	Lekbibaj	86.1
6	Margegaj	70
7	Llugaj	33.2

8	Qyteti Bajram Curri	13
	TOTAL	449.7

Burimi: Drejtoria Sherbimeve Bashkia Tropoje

1.8 Industria minerale nëntokësore

Sektori mineral është një nga resurset me të mëdha të rajonit për sa i takon nxjerrjes së kromit. Minierat e Kamit janë të njohura në të gjithë Shqipërinë për prodhimin e madh të këtij minerali si dhe numrit të madh të punësuarve. Minerale të gjenden në Tropojë përfaqësohen nga lëndë të djegshme organike si qymyret në fshatin T'pla, kromi në Malësinë e Bytyçit, hekuri në Lekbibaj, minerale metalor me ngjyrë (të bakrit, plumbit e zinkut), në zonën e Gashit, të metaleve të lehta (të aluminit) që përfaqësohen nga minerale të boksitëve në zonën e Alpeve Shqiptare, metaleve të rralla e të çmuara (platinin) në rajonin e Stoberdës. Në rajonin e Tropojës janë zbuluar gjithashtu rezerva të rëndësishme të mineraleve jo metalore, industrial dhe të ndërtimit si: kuarci i pastër në fshatin e Kernajës dhe zonën e Gashit, argjila industriale në fshatin e Tropojë e vjetër dhe Luzhë, gëlqerori në Fierzë, dolomitë në Alpe, olivinitet me rezerva të mëdha, granite në Fierzë, gurë zburimi, mermere dhe material të shumëllojshëm ndërtimi. Gjithashtu Tropoja është e pasur me minerale të dobishme ujore në të cilat përfshihen ujërat nëntokësor të pijshëm, industrial, bujqësor e ujërat minerale.

Janë zbuluar vendbanime të rëndësishme kromi, qymyri, hekuri, polimetalesh, boksiti, asbesti, alivinit, argjilash, gurësh dekorativ, material ndërtimi shumë të tjerë. Xeherorët e kromit janë një pasuri e madhe nëntokësore që lidhet me masivin e madh ofiolitik të Tropojës dhe lokalizohet në zonën mineralmbajtëse të Bytyçit, ku janë lokalizuar vendburime relativisht të mëdha dhe të pasura të kromit metalurgjik si vendburimi i Rragamit, T'planit, Kamit, Zogajt, Lajthizës, Qafë-Prushit, që janë shfrytëzuara dhe po shfrytëzohen masivisht. Aktualisht punojnë disa kompani në nxjerrjen e kromit, ku janë punësuar dhjetëra punonjës.

1.9 Profili Turistik

Bukuritë dhe pasuritë natyrore e bëjnë Tropojën një destinacion të rëndësishëm të turizmit malor. Një ndër atraksionet kryesore të Tropojës, por edhe të Shqipërisë, është Lugina e Valbonës (8000 ha) e shpallur Park Natyror Kombëtar. Ajo është zona malore më e vizituar në Shqipëri me rreth 100 mijë vizitor në vit. Por Tropoja ka shumë atraksione të tjera turistike të pashfrytëzuara. Alpet në zonën e Tropojës përbëhen nga male të larta dhe të thepisur dhe shumë tërheqës. Lugina e Gashit me sipërfaqe 3000 ha është zonë natyrore e mbrojtur strikte, dhe ahishtja e kësaj zone është në mbrojtje të UNESCO-s si trashëgimi natyror botëror.

Territori i Bashkisë Tropojë preket nga lumi Drin dhe baseni i Liqenit të Fierzës me sipërfaqe 72.5 km². Këto dy elemente natyrore së bashku me luginat e pyllëzuara ofrojnë ndër peizazhet më të bukura malore të vendit tonë. Në zonën e Fierzës, pikërisht ku bashkohet Valbona me Drinin, ekziston një territor mjaft interesant me perspektive turizmin.

Brenda territorit të bashkisë Tropojë gjenden rreth 19 monumente kulturore dhe 30 monumente natyrore, të kategorizuara si biomonumente, gjeomonumente dhe hidromonumente. Janë 27 hotele dhe bujtina vetëm në zonën e valbones me 680 shtretër për pritjen e turistëve.

2. Popullsia aktive , punësimi dhe papunësia

Duke ju referuar të dhënave Census 2011, rezulton se Bashkia e Tropojës gëzon një popullsi në moshë pune (15-65 vjeç) relativisht të lartë e cila përfaqëson 64% të popullsisë rezidente. Por pritet që në 2031, pjesa e kësaj grupmoshe të përfaqëson vetëm 59% të popullsisë. Kjo rënie e popullsisë në moshë pune rrjedh si pasojë e tendencës të lartë të popullsisë për të emigruar. Nga të punësuarit, pjesa më e madhe i përket sektorit publik ku janë 72 % e të punësuarve. Kjo dëshmon për rëndësinë e sektorit publik përse i përket punësimit dhe nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik që nuk ka gjeneruar punësim për banorët e Tropojës.

Në kuadrin e sektorit publik, shumica e të punësuarve i përkasin kategorisë së sektorit publik buxhetor (80%). Në kuadrin e sektorit privat, shumica dërmuese e të punësuarve janë tek subjektet juridike (79%). Këto subjekte privatë juridike janë kryesisht firma vendase.

Në total, rreth 2.500 të papunë kërkojnë punësim në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe në sektorin publik shtetëror (përfshirë këtu fermerët e vetëpunësuar në bujqësi).

Vërehet se punëkërkuessit që marrin ndihmë ekonomike zënë një përqindje shumë të lartë (68%). Gjithashtu, të rinjve me moshë 20-29 vjeç zënë një përqindje të konsiderueshme të punëkërkuessve- 30% e punëkërkuessve gjithsej.

Të gjitha Njësitë e Bashkisë Tropojë preken nga një shkallë papunësie tepër e lartë që arrin vlerën mesatare të 48 % të popullsisë në moshë pune, çka tejkalon ndjeshëm mesataren kombëtare